

## Regjistri i Magjistratëve Propozim nga Shoqëria Civile Plan Veprimi OGP, komponenti Drejtësi dhe Digjitalizim

<b>Lënda:</b>	Propozim Plan Veprimi OGP 2021-22, Krijimi i Regjistrit të Magjistratëve. Komponentët Drejtësi dhe Digjitalizim
<b>Propozues:</b>	OJF Instituti Shqiptar i Shkencave / Open Data Albania
<b>Drejtuar:</b>	Komitetit Teknik për Hartimin e Plan Veprimit OGP 2021-2022
<b>CC:</b>	znj. Etilda GJONI, Minitria e Drejtësisë.
<b>CC:</b>	Mirlinda KARCANAJ, Axhensia Kombëtare e e Shoqërisë së Informacionit.

### Të nderuar zyrtarë të lartë pjesëmarrës në Komitetin Teknik,

Duke shprehur konsideratë për punën tuaj dhe duke Ju uruar suksese në përgatitjen e Planit të Veprimit të Qeverisë Shqiptare për Partneritetin e Qeverisjes së Hapur, 2021-2022 organizata jonë dëshiron të dorëzojë si propozim zyrtar një aktivitet për të cilin mendon se është i rëndësishëm, aktual dhe konkret për Shqipërinë.

Paraprakisht Instituti Shqiptar i Shkencave (këtu e në vijim AIS) është një organizatë jo fitimprurëse e regjistruar prej 2011 në Regjistrin e Jofitimprurësve pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Organizata njihet si promotore e Open Data për Shqipërinë, dhe ka zbatuar disa projekte për transparencë, llogaridhënie dhe mirëqeverisje. Ne kemi marrë pjesë në hartimin e plan veprimeve dhe konsultimeve që në fillimet e procesit 2012, dhe kemi propozuar disa aktivitete të përmblytura më pas nga Qeveritë. Inovacioni dhe Digjitalizimi është gjithashtu pjesë e Objektit tonë të punës dhe ekspertizës.

Në kudër të Plan Veprimit për OGP 2021-2022 kërkesa dhe propozimi ynë është:

- **Krijimi i Regjistrit të Magjistratëve, Pjesa e Administrimit dhe Pjesa për Akses Publik, si regjistër i digjitalizuar dhe elektronik.**

Ky aktivitet, është një fakt një detyrim ligjor i vendosur nga Ligji nr. 96/2016 “Për statusin e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” në Nenin 38. Ky regjistër do të duhet të jetë një bazë unike e të dhënave dhe si i tillë kërkon *një zgjidhje softwar-ike*. Kategoria e aktiviteteve do të duhet të jetë për sisteme Data Mining.

Ky aktivitet duhet të parashikohet në Plan Veprimi OGP si pjesë e dy Komponentëve nga katër që janë në tërësi. Konkretisht në komponentin Drejtësi dhe në komponentin Digjitalizim. Institucionet që angazhohen për krijimin e Regjistrit të Magjistratëve janë disa. Përfutuese drejtpërdrejt janë dy Institucione Publike të reja të krijuara pas Reformës në Drejtësi si KLP dhe KLGJ. Buxhetimi për këtë shërbim do të duhet të jetë nga Financimi Publik dhe Donatorët. Ekspertiza mund të jetë lokale ose e ndërkombëtare. Ndërhyrja lidhet me katër etapa: Plotësim Akte Nën Ligjore; Infrastrukturë Software; infrastrukturë Hardware dhe kapacitete staf implementues.

Krijimi i Regjistrit të Magjistratëve është një aktivitet me impakt në Integritetin e Reformës dhe Sektorit të Drejtësisë. Kjo arkivë është parakusht për zhvillime të proceseve që lidhen me performancën, karrierën dhe vlerësimin e individëve Gjyqtarë dhe Prokuror. Besimi i publikut është gjithashtu i lidhur me funksionimin e Regjistrit pjesa me akses për publikun. Krijimi i Regjistrit është një nga standardet që lidhet me rëndësinë e Reformimit të Sektorit të Drejtësisë.

Organizata jonë po punon aktualisht për një model pilot të Regjistrit, të krijuar me të dhëna dhe dokumenta që mirë - strukturoren në databazë duke përdorur aksesin në informim. Qëllimi është lehtësim e punës për gazetarë dhe individ që dëshirojnë të kenë informacion dhe lehtësi akses.

DataBaza Akses Info Drejtësi është krijuar nga AIS <http://ais.al/new/>

Njoftim për Akses Info Drejtësi: <http://ais.al/new/akses-info-drejtësi-nje-regjister-publik-per-magjistratet-krijuar-nga-nje-organizate-jo-qeveritare/>

Përtej përpjekjes tonë është shumë e rëndësishme që Regjistri të krijohet dhe funksionojë sipas kërkesave Ligjore nga vetë Institucionet. Një aktivitet për Realizim të Regjistrit të Magjistratëve si pjesë e Plan Veprimit komponenti Drejtësi dhe Digjitalizim është një objektiv shumë konkret dhe i dobishëm për angazhimet e Plan Veprimit 2021 – 2022.

Duke shpresuar që ky aktivitet propozim i yni të bëhet pjesë e Plan Veprimit të Qeverisë shqiptare për OPG, ne mbetemi në dispozicion për bashkëpunim dhe konsultimit të mëtejshëm.

Me respekt

Aranita BRAHAJ  
Drejtoresh Ekzekutive  
Instituti Shqiptar i Shkencave